

**Hamëz (Arif) Ukaj**

(14.09.1955, shqiptar nga Romaja, komuna e Prizrenit/Prizren, bukëpjekës, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Kujtimi me djalin e axhës Enverin dhe djalin e hallës së Enverit, Samiun, u nisën nga Pagarusha/Pagaruša [Malishevë/Mališevo] për në Shqipëri më 10.10.1998, për një ngarkesë armatimesh. Për një kohë të shkurtër, qëndruan në Krushë të Madhe/Velika Kruša. Më pas, më 13.10.1998, kaluan në Gjonaj/Đonaj, në shtëpinë e komandanti lokal të UÇK-së, Hamzë Miftari. Në datën **15.10.1998**, u nisën drejt kufirit në kuadrin e grupit të UÇK-së, ku bënë pjesë edhe Hamëz Ukaj. Në afërsi të postbllokut ushtarak të **Gorozhupit/Goruzup**, në bjeshkën e *Pashtrikut/Paštrik*, Enveri, Kujtimi, Samiu dhe Hamza kanë rënë në një fushë të minuar. Enveri, Kujtimi dhe Samiu e humbën jetën menjëherë, ndërkaq Hamza vetëm u plagos, por pas pak ndërroi jetë. Bashkëluftëtarët ia arritën më 18.10.1998 ta tërhiqnin trupin e Hamzës dhe ta varrosnin në fshatin Vllanë [Shqipëri]. Dy ditë më vonë, kufitarët serb i kanë marrë dhe i kanë bartur trupat e Enverit, Kujtimit dhe Samiut në spitalin e Prizrenit/Prizren. Në datën 26.10.1998, familjarët i kanë marrë trupat e të vvarëve. Po atë ditë, Enveri dhe Kujtimi u varrosën në varrezat e Shkozës/Milanović, përderisa Samiu u varros në varrezat e Pagarushës/Pagaruša. Pas lufte, më 18.10.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Hamzës në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës, në Landovicë/Landovica.

**Burimet:** deklarata V.K, FDH-35610; deklarata M.B, FDH-17234; deklarata G.U, FDH-20890; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.3D01009, FDH-31364; *Identity of Two Other Teenagers Killed in Serb Minefield Established*, pasqyra e lajmeve, KIC, 26.10.1998, FDH-29779; *Four Kosovars Killed in Minefield along Kosova-Albanian Border*, pasqyra e lajmeve, KIC, 17.10.1998, FDH-29770; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

**Sinan (Abaz) Hoti**

(13.6.1951, shqiptar nga Krusha e Madhe/Velika Kruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, inxhinier i makinerisë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

**Muhamet (Nuredin) Malësori**

(4.10.1955, shqiptar nga Krusha e Madhe/Velika Kruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, sociolog, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

**Skender (Rexhep) Hameli**

(28.06.1958, shqiptar nga Mazreku/Mazrek, komuna e Prizrenit/Prizren, bukëpjekës, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

**Hysni (Xhafer) Duraku**

(13.01.1961, shqiptar nga Krusha e Madhe/Velika Kruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, bukëpjekës, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

**Sedat (Aziz) Hoti**

(11.5.1974, shqiptar nga Krusha e Madhe/Velika Kruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, mësues, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

**Isak (Adem) Hoti**

(9.08.1974, shqiptar nga Krusha e Madhe/Velika Kruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, inxhinier i makinerisë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

**Ismet (Daut) Hoti**

(31.12.1975, shqiptar nga Krusha e Madhe/Velika Kruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, jurist, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

**Hida (Isa) Hoti**

(3.01.1976, shqiptar nga Krusha e Madhe/Velika Kruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, arkitekt, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Në fillim të vitit 1998, burrat e Krushës së Madhe/Velika Kruša e kanë themeluar një njësit të UÇK-së. Muhamedi ka qenë një nga themeluesit. Pas pak, njësitit i janë bashkangjitur Hysniu, Hidai, Isaku, Ismeti, Sedati, Sinani dhe burra të tjerë të fshatit. Në fillim të muajit shtator, forcat serbe u dhanë ultimatum banorëve të fshatit që të dorëzonin armët. Për këtë arsye, shumica e burrave ka shkuar në Tiranë [Shqipëri]. Muhamedi ka qëndruar për një kohë në fshat, por edhe ai, së shpejti, iu bashkëngjiti këtij grupi. Pas pak, kaluan në fshatin kufitar të Cahanit, ku grupit iu bashkëngjiti edhe Skenderi. Në natën mes datave 2 dhe **3.12.1998**, ata që të gjithë u nisën përmes *Pashtrikut/Paštrik* në Kosovë. Në vendin e quajtur *Uji i Trungut*, te **Planeja**, ata kanë rënë në pusi të kufitarëve të UJ-së. Të gjithë kanë rënë në këtë betejë. Ushtarët e UJ-së i kanë bartur trupat e Muhametit dhe të tjerëve në spitalin e Prizrenit/